

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR PËR VITIN 2021

➤ *Bashkëpunimi me Institucionet Homologe në Rajon, Evropë dhe më gjërë*

Në janar të vitit 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca mori pjesë në forumin rajonal të organizuar në kuadrin e rrjetit të Ombudsmanëve të Ballkanit. Takimi u organizua me qëllim trajtimin e disa çështjeve me rëndësi për funksionimin e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në rajonin tonë. Midis temave të trajtuara u përfshinë ato mbi përvojat e institucioneve të të drejtave të njeriut në Ballkan në kushtet e pandemisë si dhe hapat dhe ecuria e konsolidimit të rrjetit rajonal të Ombudsmanëve. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova, Serbia e Turqia.

Në maj të vitit 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca zhvilloi një vizitë pune në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjatë vizitës ajo dhe delegacioni që e shoqëronte zhvilloi takime me homologun e saj të sapozgjedhur në këtë post Z. Naser Ziberi si dhe me Avokatin e Popullit të Kosovës, Z. Naim Qelaj, i cili po ashtu ishte pjesë e organizimit të këtij takimi trepalësh. Objekti i takimeve ishin diskutimet mbi thellimin e bashkëpunimit mes tre institucioneve dhe shkëmbimi i eksperiencave. Gjatë vizitës në Shkup, Avokatët e Popullit të të tria vendeve u pritën edhe nga Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Z. Talat Xhaferi.

Në qershor të vitit 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca mikpriti në një vizitë zyrtare një delegacion nga institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës. Delegacioni Kosovar kryesohej nga Avokati i Popullit të Kosovës Z. Naim Qelaj dhe zyrtarë të tjerë të lartë të këtij institucioni. Në këtë vizitë u organizuan takime në Kuvendin e Shqipërisë, në Gjykatën Kushtetuese e po ashtu një intervistë e përbashkët e dy avokatëve shqiptarë të popullit në studion e Radio Televizionit Publik Shqiptar.

Në dhjetor të vitit 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca së bashku me Komisioneren e Seksionit të Përgjithshëm znj. Vilma Shurdha, morën pjesë në takimin e katërt rajonal në Kosovë mes Avokatëve të Popullit dhe institucioneve të tjera të të Drejtave të Njeriut të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Ky takim u organizua bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit, të nënshkruar në Vlorë në vitin 2019, dhe synoi vazhdimin e diskutimit lidhur me punën e përbashkët në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në shtetet respektive dhe avancimin e bashkëpunimit në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Po ashtu, gjatë vizitës u organizuan takime me Presidenten e Kosovës, znj. Vjosa Osmani dhe kryetaren e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani. Në këto takime u diskutua gjendja e përgjithshme e të drejtave të njeriut në shtetet respektive dhe puna në promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Po në dhjetor të vitit 2021, një delegacion homolog nga Armenia vizitoi Institucionin e Avokatit të Popullit të Shqipërisë. Delegacioni Armen, fokusi dhe përbërja e të cilit ishte mbrojtja kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor, u prit nga Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca, Komisionerja e Mekanizmit Kundër Torturës znj. Ermonela Xhafa. Në këtë kuadër, janë realizuar një sërë vizitash monitoruese pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Institucioneve të Shëndetit Mendor dhe komisaritet e policisë.

➤ **Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera**

- *Bashkëpunimi në kuadër të Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)*

Ndër të tjera, Avokati i Popullit ka marrë pjesë edhe në një sërë aktivitete të organizuar nga AOM, përgjatë vitit 2021 si:

- ✓ *Takimin e 11-të të Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)*, mbajtur në Nafplio (Greqi), më datë 4 dhe 5 tetor 2021. Në këtë takim institucioni i Avokatit të Popullit përfaqësohej nga znj. Erinda Ballanca e cila adresoi çështjen e ndryshimeve klimatike dhe lidhjen me të drejtat e njeriut. Ndër të tjera, AOM inkurajoi me anë të një deklaratë “të gjitha vendet në rajonin e Mesdheut dhe rajonin fqinj që të koordinojnë politikat e tyre për mbrojtjen civile dhe të zhvillojnë politika të përgjithshme dhe, nëse është e mundur, kapacitete të integruara për të ofruar ndihmë operationale dhe ndihmë emergjente në rast fatkeqësish natyrore”.
- ✓ Konferenca online me titull “*Media dhe teknologjia moderne në punën e Ombudsmanëve*” organizuar nga Mbrojtësi i të Drejtave të Njeriut të Armenisë në bashkëpunim me Shoqatën e Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM). Në këtë konferencë morën pjesë institucione të të drejtave të njeriut nga Shqipëria, Belgjika, Danimarka, Kroacia, Qiproja, Gjermania, Izraeli, Greqia, Malta dhe vende të tjera. Avokati i Popullit përfaqësohet në këtë veprimtari nga znj. Erinda Ballanca dhe këshilltari për mediat, të cilët prezantuan punën e institucionit dhe nënvizuan rëndësinë e shkëmbimit të përvojave.
- ✓ “*Konferenca ndërkombëtare online mbi rolin e ombudsman-it në përmirësimin e të drejtave të Moshuarve*”, organizuar nga Zyra e Kontrollorit Shtetëror dhe Ombudsmanit të Izraelit, në bashkëpunim me IOI dhe AOM, në datë 8 Shtator 2021. Në këtë veprimtari Avokati Popullit përfaqësohej nga Komisionerja znj. Vilma Shurdha dhe ndihmëskomisionerë nga Seksioni i Përgjithshëm. Ndër të tjera, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca përmes një video mesazhi adresoi çështjet e të drejtave të moshuarve në kontekstin e Shqipërisë.
- *Bashkëpunimi në kuadër të Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI) dhe Aleancës Globale të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI)*

Përgjatë vitit 2021 përfaqësues të Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë në një sërë veprimtarish të organizuar nga GANHRI si më poshtë vijon:

- ✓ *Në datën 18 mars 2021*, u zhvillua seminari virtual për grupin e punës së GANHRI-t mbi “*Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (UNGP)*”. Në këtë seminar u diskutuan rolet dhe përvojat e IKDNJ-ve në zbatimin e mandateve të Parimeve të Parisit dhe zbatimin e Planeve Kombëtare të Veprimit (NAPs).
- ✓ *Në datat 29 Qershor – 1 Korrik 2021*, u organizua “*takimi vjetor i Aleancës Globale të Institucioneve të të Drejtave të Njeriut*”. Takimi kishte qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira dhe është një aktivitet i përvitshëm i cili organizohet me vendet anëtare të GANHRI-t të. Ndër të tjera Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca moderoi sesionin “*Shkëmbimi i përvojave më të mira ndërmjet anëtarëve të IOI*”.

- ✓ Në datën 6 tetor 2021, u organizua aktiviteti online “*Mbi qasjen e Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut ndaj të drejtave të njeriut, veprimeve klimatike dhe e drejta për një mjedis të shëndetshëm*”, në të cilën mori pjesë Komisionerja e Seksionit të Përgjithshëm znj. Vilma Shurdha dhe përfaqësues të tjerë të lartë të institucionit. Fokusi kryesor i këtij aktiviteti ishte rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut si agjentët kryesorë dhe mekanizmat më reagues në mbështetje të të drejtave të brezave të ardhshëm.
- ✓ Në datën 12 tetor 2021, u organizua aktiviteti online “*Koordinimi midis aktorëve kombëtarë të drejtave të njeriut dhe angazhimi efektiv në sistemin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut*”. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi në nivel kombëtar i institucioneve të të drejtave të njeriut, si dhe lidhja e tyre me mekanizmat e OKB-së për të drejtat e njeriut në kontekstin e monitorimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut.
- ✓ Në datën 28 tetor 2021, u zhvillua aktiviteti online “*Forcimi i Kombeve të Bashkuara me në qendër viktimat ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit seksual përmes partneriteteve me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut-sfidat dhe mundësitë*”, i organizuar nga GANHRI dhe OVRA, në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara dhe NHRI-të. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut ndaj sfidave specifike të mbrojtjes së të drejtave të viktimave të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, shkëmbimi i praktikave dhe mundësive të mira në mbështetje të realizimit të të drejtave të viktimave për ndihmë dhe mbështetje.
- ✓ Në datat 3-5 nëntor 2021, në kuadër të ndryshimeve klimaterike, u mbajt simpoziumi online me temë “*Raporti i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe politikat e ndryshimeve klimaterike COP26*”, në të cilin mori pjesë Komisionerja e Seksionit të Përgjithshëm znj. Vilma Shurdha. Ky simpozium mblodhi Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI-të) nga të gjitha rajonet me qëllim shkëmbimin e praktikave dhe përvojave më të mira midis tyre në funksion të promovimit dhe mbështetjes së të drejtave të njeriut në raport me politikën e çështjeve klimaterike dhe përgjegjësinë ndaj saj.

Përgjatë vitit 2021 përfaqësues të Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë në një sërë veprimtarish të organizuar nga ENNHRI si më poshtë vijon;

- ✓ Në datën 10 shkurt 2021, u zhvillua takimi online “*Mbi shkeljen e të drejtave të njeriut të krijuar nga draft protokollit shtesë i Konventës së Oviedos*”, organizuar nga Forumi Evropian i Personave me Aftësi të Kufizuar (EDF) dhe Shëndetit Mendor Evropian (MHE) me mbështetjen e EQUINET dhe ENNHRI (Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjeksisë).
- ✓ Në datën 4 Mars 2021, u zhvillua webinar i me temë “*COVID-19, institucionalizimi i personave me aftësi të kufizuara dhe e drejta për të vërtetën*”, organizuar nga Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENHHRI) në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR). Në këtë veprimtari janë trajtuar "shkelje serioze e të drejtave të njeriut" dhe ndikimi i COVID-19.
- ✓ Në datat 26-27 prill 2021, Avokatja e Popullit Znj. Ballanca mori pjesë si moderatore në panel në Takimin e Nivelit të Lartë, të organizuar nga ENNHRI dhe Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “*Rekomandimet për zhvillimin dhe forcimin e institucioneve kombëtare efektive, pluraliste dhe të pavarura për të drejtat e njeriut*”. Ky takim nxiti përfshirjen, bashkëpunimin e mëtejshëm të rolit qendror të IKDNJ-ve me ENNHRI dhe në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë, në kuadër të bashkëpunimit efektiv me Këshillin e Evropës.

- ✓ Në 29 prill 2021, u zhvillua takimi online “Mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm me në fokus rolin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në Rishikimin Vullnetar Kombëtar (VNR)”, takim i cili u ndoq nga përfaqësues të Kabinetit të Avokatit të Popullit. Në këtë takim u prezantuan përvojat e anëtarëve të IKDNJ-ve lidhur me angazhimin me Rishikimin Vullnetar Kombëtar.
- ✓ Në datën 29 prill 2021, u zhvillua webinarin me temë “Strategjia e personave me aftësi të kufizuar 2021-2030”, të organizuar nga ENNHRI dhe Equinet, webinar i cili u ndoq nga përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm. Synimi i webinar-it ishte analizimi i Strategjisë dhe lejimi i hapësirës për të diskutuar rolin që mund të kenë IKDNJ-të dhe Organet e Barazisë në zbatimin efektiv të Strategjive në nivelin kombëtar (për aq sa lejojnë mandatet e tyre).
- ✓ Në datat 1 dhe 2 qershor 2021, u mbajt takimi online i ENNHRI me fokus “Qasjen e të drejtave të njeriut ndaj vaksinës COVID-19 nga Grupi i Punës për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale të ENNHRI-t”. Takim u përqëndrua tek mundësia dhe garantimi i aksesit të vaksinimit në kontekstin e barazisë për të gjitha shtetet si pjesë e strategjisë për të kapërcyer pandeminë COVID-19. Ky takim u ndoq nga përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm.
- ✓ Në datat 2-3 Qershor 2021, Avokatja e Popullit Znj. Erinda Ballanca mori pjesë në Takimin e Nivelit të lartë të ENNHRI me temë “Të garantojmë respektimin e të drejtave të njeriut për emigrantët në kufi: Roli i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut”. Avokatja e Popullit Znj. Ballanca moderoi një nga panelet e këtij takimi e përkatësisht atë me temë “Nxitja e ndryshimit në nivel kombëtar drejt respektimit të të drejtave të njeriut për emigrantët në kufi përmes punës së institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut dhe mbrojtësve të të tjerë të të drejtave humane”. Në takim mori pjesë edhe Komisionerja e Mekanizmit Kombëtar Kundër Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor Znj. Ermonela Xhafa.
- ✓ Në datat 11-25 qershor 2021, ENNHRI në bashkëpunim me ODHIR organizuan online “Akademinë e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut”. Në sesionin e hapjes Avokatja e Popullit Znj. Erinda Ballanca në fjalën e saj nënvizoi rëndësinë e akademisë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në rajonin e OSBE-së. Në këtë veprimtari çdo vit përfaqësues të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në rajonin e OSBE, trajnohen mbi çështjet e të drejtave të njeriut.
- ✓ Në datat 20-22 tetor 2021, u organizua nga Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore (FRA) në bashkëpunim me EQUINET dhe ENNHRI seminari online për “Rolin e Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore në punën e Organeve të Barazisë dhe Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut”, në të cilin morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë të Institucionit të Avokatit të Popullit. Tema e diskutimit u përqëndrua tek roli i Organeve të Barazisë dhe Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, mundësitë e reja të financimit, si dhe risitë e të drejtave themelore në aspektin horizontal që janë kusht për fondet e BE –së.
- ✓ Në periudhën 1 nëntor 2021-24 Janar 2022, u zhvillua kursi online për “Të drejtat e njeriut dhe Agjenda 2030. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe roli i IKDNJ-ve në rajonin e UNECE”, i organizuar në bashkëpunim midis ENNHRI dhe DIHR, në të cilin morën pjesë përfaqësues të nivelit të mesëm drejtues të Institucionit të Avokatit të Popullit.
- ✓ Në datat 10-26 Nëntor 2021, Avokatja e Popullit Znj. Erinda Ballanca mori pjesë online në “Forumit i Liderit të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ) për vitin 2021”, në të cilin cilin ishin ftuar të marrin pjesë drejtuesit e IKDNJ-ve anëtare të ENNHRI-t. Në këtë forum u trajtuan sfidat e liderit të IKDNJ-ve përballë vendimeve të komplikuar në situatën e COVID -19.
- ✓ Në datat 22-23 Nëntor 2021, përfaqësues nga kabineti i Avokatit të Popullit, Seksioni i Përgjithshëm dhe Seksioni i Administratës ndoqën trajnimin online me temë “Zbatimi i një analize të të drejtave të njeriut bazuar në planet kombëtare të rimëkëmbjes ndaj COVID-19”.

Qëllimi kryesor i organizimit të këtij trajnimi ishte analiza dhe ndikimi socio-ekonomik që ka pasur pandemia e COVID-19 si dhe planet kombëtare të veprimit që kanë ndërmarrë qeveritë për të nxjerrë vendet përkatëse nga kjo situatë.

- *Bashkëpunimi në kuadër të Shoqatës së Ombudsmanëve Frankofonë (AOMF)*

Përgjatë vitit 2021 përfaqësues të Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë në një sërë veprimtarish të organizuar nga AOMF si vijon:

- ✓ *Në datat 12- 13 Korrik 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca mori pjesë në takimin e Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësuesve Frankofonë, i cili u mbajt në Monako (Francë), me fokus marrëdhënien midis të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së mjedisit. Në fjalën e saj, Avokatja e Popullit Znj. Ballanca theksoi ndërmjet të tjerash se zbatimi i ligjeve dhe politikave të lidhura me mjedisin mund të ndikojë në gëzimin e të drejtave të njeriut.*
- ✓ *Në datën 20 maj 2021, u organizua online Trajnimi mbi komunikimin. Ky aktivitet synonte trajnimin e përfaqësuesve të Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut mbi komunikimin dhe aplikacionet në celular si një portë e vërtetë për qytetarët.*
- ✓ *Më datë 8 korrik 2021, u organizua online kursi i trajnimit “Të zbatosh të drejtat e fëmijës, mënyrat e veprimit dhe të zgjidhjes”. Ky kurs synonte të prezantonte platformën për të drejtat e fëmijëve CLOM me qëllim rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut.*
- ✓ *Në datat 30 nëntor-2 dhjetor 2021, u organizua në formë hibride (Në Bruksel dhe online) trajnimi mbi “Përdorimin e softuerit kompjuterik për trajtimin e ankesave”. Ky aktivitet synonte prezantimin e softuerit të AOMF-së, që mund të implementohet brenda institucioneve si edhe shkëmbimin e informacionit për komunikimin e brendshëm të institucioneve.*
- ✓ *Në datën 2 dhjetor 2021, u organizua në formatin online webinarin mbi të drejtat e fëmijës, në platformën CLOM AOMF. Ky webinar synonte shkëmbimin e ideve dhe eksperiencave ndërmjet vendeve anëtare.*

- *Bashkëpunimi në kuadër të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI)*

Përgjatë vitit 2021 përfaqësues të Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë në një sërë veprimtarish të organizuar nga IOI si vijon:

- ✓ *Në datën 23 shkurt 2021, në Seminarin online me temë “Rezoluta e Kombeve të Bashkuara në Institucionet e Ombudsmanit dhe ndërmjetësuesit institucional”. Në këtë seminar morën pjesë mbi 100 delegatë nga e gjithë bota, të cilët diskutuan mbi rëndësinë e Rezolutës së OKB-së për rolin e institucioneve të Ombudsmanit, e cila është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 16 dhjetor 2020.*
- ✓ *Në datën 20 prill 2021, në Seminarin online mbi “Vizitat monitoruese në vendet e privimit të lirisë”. Në këtë seminar u diskutua në lidhje me Protokollin Opsional të Konventës Kundër Torturës (OPCAT) dhe kuptimi i saj në punën e Ombudsman-it.*
- ✓ *Në datën të 25 maj 2021, u organizua katimi online nga Asambleja e Përgjithshme e IOI-së, ku morën pjesë 130 institucione anëtare të IOI-së dhe Bordi i Drejtorëve të IOI-së. Në këtë takim u prezantuan zhvillimet dhe arritjet e organizatës ndër vite si dhe miratimin e ndryshimeve në aktet nënligjore të IOI-së.*

- ✓ Në datat 11-12 tetor 2021, u zhvillua online *Forumi i të Drejtave Themelore të FRA-së 2021*, organizuar nga Agjencia për të Drejtat Themelore të Bashkimit (FRA) në bashkëpunim me IOI, në lidhje me perspektivat e ombudsman-it për emigrimin në Evropë, forum i cili u ndoq nga përfaqësues nga Seksioni i Veçantë dhe Seksioni i Mekanizmit për Parandalimin e Torturës.
 - ✓ Në 20 prill 2021, u zhvillua aktiviteti online *“Takime në vendet e paraburgimit”*, organizuar nga Qendra e Kërkimeve të Ombudsmanit të Afrikës (AORC) në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI). Ky aktivitet u ndoq nga përfaqësues të Seksionit të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.
- *Aktivitete të tjera në kuadër të bashkëpunimit me organizata ndryshme ndërkombëtare*
- ✓ Në datën 14 janar 2021, përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në seminarin online me temë *“Integrimin e të drejtave të njeriut në rimëkëmbjen e qëndrueshme dhe elastike nga pandemia COVID-19”*, duke u fokusuar në zbatimin e Agjendës së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
 - ✓ Në datat 3 dhe 4 shkurt 2021, u mbajt webinari me temë *“Dorëzimi në mënyrë sa më efektive i raportit të Rishikimit Periodik Universal (UPR) nga ana e palëve të interesuara”*, në të cilën morën pjesë përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit.
 - ✓ Në datat 4, 11, 18 dhe 25 shkurt 2021, përfaqësues nga Kabineti i Avokatit të Popullit ndoqën Konferencën online *“Qytetari dhe administrata përballë gjyqtarit dhe ndërmjetësuesit institucional”* të organizuar nga institucioni ndërmjetës i Wallonit dhe Federatës Walloni-Bruksel.
 - ✓ Në 10 shkurt 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi z.Robert Gajda kryen një vizitë në *Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë*. Gjatë takimit palët po ashtu diskutuan edhe ndikimin e pandemisë Covid-19 në të drejtat e njeriut në Kosovë dhe Shqipëri dhe puna që është bërë nga të dyja institucionet në adresimin e ankesave të qytetarëve.
 - ✓ Në 10 shkurt 2021, përfaqësues nga Seksioni i Veçantë morën pjesë online në *Takimin Ndërsektorial për Parandalimin e Genocidit*.
 - ✓ Në 11 shkurt 2021, u zhvillua webinar-i mbi *seancën e 46-të të Këshillit të të Drejtave të Njeriut*, organizuar nga Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut dhe Misionet e Përhershme të Danimarkës dhe Sllovenisë në Kombet e Bashkuara në Gjenevë, në të cilën morën pjesë Komisionerja e Seksionit të Përgjithshëm znj. Vilma Shurdha dhe Komisionerja e Seksionit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve znj. Neila Peka.
 - ✓ Në datë 18 shkurt 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca dhe Seksioni i Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Institucionin e Avokatit të Popullit, morën pjesë në takim rajonal të organizuar nga UNICEF për përgatitjen e Instrumentit të Vlerësimit të Ndikimit të të Drejtave të Fëmijës (CRIA) në lidhje me COVID-19.
 - ✓ Në datën 5 mars 2021, me mbështetjen e OSCE/ODIHR u organizua nga Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë (DCAF) webinari *“Publikimi i të Drejtave të Njeriut për Personelin e Forcave të Armatosura”*, në të cilën morën pjesë përfaqësues nga Seksioni i Veçantë.
 - ✓ Në datat 15-19 Mars 2021, Shoqata për Parandalimin e Torturës (APT) në bashkëpunim me OSCE/ODIHR, organizuan takimin online të Mekanizmave Kombëtar të Parandalimit të Torturës (NPM) dhe Organizatave të Shoqërisë Civile (CSO) nga rajoni i OSCE-së me temë *“Mbi monitorimet e vendeve të privimit të lirisë gjatë pandemisë”*.

- ✓ Në datën 24 Mars 2021, anëtarë të Kabinetit të Avokatit të Popullit morën pjesë në seminarin e organizuar nga Rrjeti Evropian i Ombudsmanëve (ENO) mbi *“Inteligjencën Artificiale dhe “e-government” në administratën publike”*.
- ✓ Në datën 31 mars 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca mori pjesë online në Konferencën Rajonale *“Themeli i të Drejtave të Njeriut: Institucionet Efektive Kombëtare të të Drejtave të Njeriut për Ballkanin Perëndimor”*, organizuar nga Mbrojtësit e të Drejtave Civile dhe Instituti i Politikave Evropiane.
- ✓ Në datën 17 prill 2021, Institucioni i Ombudsmanit të Mbretërisë së Marokut, Këshilli i Evropës dhe Komisioni i Venecias, organizuan webinarin ndërkombëtar mbi Rezolutën e Kombeve të Bashkuara me temë: *“Roli i Ombudsmanit dhe institucioneve ndërmjetësuese në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mirëqeverisja dhe shteti i së drejtës”*.
- ✓ Në datë 17 prill 2021, përfaqësues nga Seksioni i Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve morën pjesë në konferencën online *“Fëmijët në migrim në Evropën Juglindore”*, organizuar nga Kampusi Global i Evropës Juglindore (GCSEE)/ Programi Master Evropian Rajonal (ERMA).
- ✓ Në datën 28 prill 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca mori pjesë në seminarin online organizuar nga Kolegji Evropës (College of Europe) me studentë të Kampusit Natolin (Poloni). Avokatja e Popullit znj. Ballanca bëri një prezantim të shkurtër të kontekstit shqiptar të të Drejtave të Njeriut, rolit dhe misionit të Avokatit të Popullit si dhe të reformës në drejtësi si një nga shtyllat kryesore të garantimit të funksionimit të shtetit ligjor.
- ✓ Në datat 10-11 maj 2021, përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në dy aktivitete të organizuar online mbi Rishikimin Periodik Universal (UPR) me temë *“Praktikat e mira për raportimin afatmesëm të UPR”* dhe *“Përmirësimi në paraqitjen e raportit të palëve të interesuar për UPR”*
- ✓ Në datën 11 maj 2021, u mbajt takimi online *“Duke ndryshuar të ardhmen e komunitetit për shërbimet e shëndetit mendor bazuar në të drejtat e njeriut”*, organizuar nga Mental Health Europe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Seksioni i Veçantë dhe Seksioni i Mekanizmit për Parandalimin e Torturës.
- ✓ Në datat 11-12 maj 2021, përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në webinarin mbi *“Parimet e Venecias dhe institucionet e Ombudsman-ëve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të Ibero-Amerikanëve dhe në Evropë”*, organizuar nga Federata e Ombudsmanëve Ibeoamerikanë (FIO) dhe Komisioni i Venecias.
- ✓ Në datën 11 Maj 2021, përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm ndoqën online panelin e diskutimit ndersektoral me temë *“Përvjetorin e pesëmbëdhjetë të përgjegjësisë për të mbrojtur popullsinë nga genocidi, krimet e luftës, spastrimet etnike dhe krimet kundër njerëzimit”*, organizuar nga OHCHR.
- ✓ Në datë 4 qershor 2021, Avokatja e Popullit znj. Ballanca mori pjesë në webinarin e organizuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri mbi mandatin e FRA-së, rolin e saj në BE dhe partneritetit ndërmjet Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) dhe Shqipërisë.
- ✓ Në datën 7 qershor 2021, Komisionerja znj. Vilma Shurdha dhe përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm morën pjesë në aktivitetin online *“Pandemia COVID-19 dhe të drejtat ekonomike e sociale”*, organizuar nga Global Campus of Human Rights në bashkëpunim me Universitetin e Sarajevos dhe të Bolonjës.
- ✓ Në datat 15-17 Qershor 2021, Komisionerja znj. Vilma Shurdha dhe përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm morën pjesë online në *sesionin e 14-të të Konferencës së Shteteve Palë (COSP) të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD)*, organizuar nga OHCHR. Çështjet e trajtuara ishin rikuperimi pas COVID-19, përmbushja e nevojave dhe

realizimi i të drejtave, adresimi i ndikimeve socio-ekonomike për personat me aftësi të kufizuara.

- ✓ Në datat 21 qershor-16 korrik 2021, Departamenti i Ligjit Ndërkombëtar të Refugjatëve dhe Ligjit të Migracionit të Institutit Ndërkombëtar të së Drejtës Humanitare në Sanremo, Itali, zhvilloi *Kursin e Parë Online mbi Joshtetësinë*. Kursi u zhvilluar kryesisht në kuadër të zbatimit të legjislacionit dhe politikave që prekin personat pa shtetësi.
- ✓ Në datën 22 qershor 2021, përfaqësues nga Seksioni i Administratës morën pjesë në webinarin për zbatimin e ligjeve të procedurës administrative në Ballkanin Perëndimor, të organizua nga OECD/SIGMA.
- ✓ Në datat 28-29 qershor 2021, përfaqësues nga Avokatit i Popullit morën pjesë në eventin “Komunikuesit e të drejtave të njeriut eksplorojnë mënyrat e trajtimit të dezinformimit” organizuar online nga FRA (Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore).
- ✓ Në datën 6 korrik 2021, përfaqësues nga Seksioni i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Seksioni i Veçantë morën pjesë në webinar-in me temë “Mekanizmi i ankesave të FRONTEX dhe monitorimin e kthimit të detyruar”.
- ✓ Në datat 13-14 korrik 2021, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë online në konsultimet e organizuar nga UPR, ku u diskutua në lidhje me pjesëmarrjen e shoqërisë civile për të inkurajuar angazhimin efektiv të tyre në ciklin e 4-rt të UPR-it dhe zbatimin e praktikave të mira.
- ✓ Në datën 15 korrik 2021, përfaqësues nga Seksioni i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Seksioni i Veçantë morën pjesë në webinar-in e organizuar nga zyra e OSBE-së me temë “Mbrojtja e të drejtave të njeriut në burgje në parandalimin e radikalizimit që çon në terrorizëm ose dhunë: udhëzuesi për vëzhguesit e paraburgimit”.
- ✓ Në datën 29 korrik 2021, në Tiranë u zhvillua seminari me temë “Hartimi i projektit i financuar nga Zvicra për shërbimin e urgjencës shëndetësore, gatishmërinë dhe veprimet”, u organizuar nga Ambasada e Zvicrës, me pjesëmarrjen dhe të përfaqësuesve nga Seksioni i Përgjithshëm.
- ✓ Në datat 3-4 shtator 2021, përfaqësues të Institutit të Avokatit të Popullit morën pjesë në forumin e 8-të rajonal vjetor i sundimit të ligjit për Evropën Juglindore që u organizua në Tiranë nga Qendra AIRE (Advice on Individual Rights in Europe) dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile. Tema e forumit ishte “Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit”.
- ✓ Në datat 20-22 shtator 2021, përfaqësues nga Seksioni i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Seksioni i Veçantë morën pjesë online në Konferencën Evropiane të MKPT-ve në zbatimin efektiv të gjyqësorit të GJEDNJ-së dhe rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës për keqtrajtimin policor dhe hetimet efektive për keqtrajtimet e pretenduar.
- ✓ Në datën 7 tetor 2021, përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm morën pjesë online në Prezantimin e Komitetit të Përgjithshëm Nr.5 të Komitetit për Punëtorët Migrantë mbi të drejtat për liri dhe siguri të migrantëve, privimin arbitrar të lirisë dhe lidhjen e tyre me të drejtat e njeriut.
- ✓ Në datën 8 tetor 2021, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë online në kuadër të sesionit të 48-të të Këshillit të të Drejtave të Njeriut.
- ✓ Në datat 11-22 tetor 2021, përfaqësues nga Seksioni i Përgjithshëm mori pjesë online në Sesionin e 19-të të Grupit Ndërqeveritar të Punës për Zbatimin Efektiv të Deklaratës dhe Programit të Veprimit të Durbanit mbi diskriminimin racor.
- ✓ Në datën 12 tetor 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca dhe Komisionerja e Seksionit të Veçantë znj. Ermonela Xhafa morën pjesë online në Konferencën e V-të Ndërkombëtare me

temë “*Mbrojtja e të drejtave të njeriut në Euroazi: shkëmbimi i praktikave më të mira të ombudsmanëve*”, që u organizua nga Komisioneri i të Drejtave të Njeriut i Federatës Ruse.

- ✓ Në datën 18 tetor 2021, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca dhe Komisionerja e Seksionit të Përgjithshëm znj. Vilma Shurdha morën pjesë në seminarin online “*Bashkimi i Forcave për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut të Personave LGBTP*”, organizuar nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI).
- ✓ Në datat 18-22 tetor 2021, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë online në konferencën e 13-të Ndërkombëtare të Institucioneve të Ombudsmanit për Forcat e Armatosura (ICOAF). Tema kryesore e konferencës ishte kontributi i Ombudsmanit në efektivitetin operacional të forcave të armatosura.
- ✓ Në datat 18-22 tetor 2021, përfaqësues nga Seksioni i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës morën pjesë në trajnimin e zhvilluar nga Frontex, në bashkëpunim me IOM-në për vëzhguesit e operacioneve të kthimit të detyruar, që u mbajt në Beograd (Serbi).
- ✓ Në datën 15 nëntor 2021, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë online në konferencën me temë “*Aksesi në dokumentat e BE-së*”, që u organizua nga Ombudsmani Evropian.
- ✓ Në datat 16-17 nëntor 2021, Komisionerja e Seksionit të Veçantë znj. Ermonela Xhafa mori pjesë online në *Sesionin e tretë të Forumit për të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit*, organizuar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR).
- ✓ Në datat 17-19 nëntor 2021, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në *Samitin e 7-të të Romëve për Ballkanin Perëndimor*, me fokus fuqizimin dhe përkrahjen e të rinjve romë përballë Bashkimit Evropian.
- ✓ Në datat 30 nëntor-03 dhjetor 2021, Avokati i Popullit në bashkëpunim me Prezencën e OSBE dhe Ministrisë së Drejtësisë, realizoi aktivitetin trajnues për menaxhimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve në Regjimin e Posaçëm në përputhje me të drejtat e njeriut.